

Të nderuar gazetarë, përfaqësues të mediave,

Në vazhden e traditës sonë të takimit me ju, kam kënaqësinë që po takohemi sot për të shënuar bashkërisht fundin e një viti të suksesshëm për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe për sistemin financiar të vendit, në të cilin komunikimi efektiv me media ka qenë pjesë e rëndësishme e këtij suksesi.

BQK-ja në vazhdimësi i ka kushtuar vëmendje të veçantë transparencës, duke qenë të hapur ndaj mediave si rreth zhvillimeve në sistemin financiar dhe në ekonomi, ashtu edhe ndaj zhvillimeve të brendshme në BQK. Ne do të vazhdojmë të kultivojmë dhe avancojmë edhe më tutje kulturën e transparencës sepse e vlerësojmë si një mekanizëm shumë të rëndësishëm të llogaridhënies dhe të ndërtimit të një raporti të qëndrueshëm ndërmjet nesh dhe publikut.

Ne besojmë fuqishëm se bashkëpunimi efektiv që kemi pasur me ju dhe gatishmëria juaj për të ndjekur dhe transmetuar në mënyrë korrekte zhvillimet e lidhura me BQK-në dhe sistemin financiar të vendit kanë dhënë kontribut shumë të rëndësishëm në ndërtimin e besimit të publikut ndaj këtij sektori shumë të rëndësishëm të ekonomisë së vendit.

Tani, më lejoni ju lutem që të shpalos para jush një përmbledhje të zhvillimeve që karakterizuan sistemin financiar dhe ekonominë e vendit gjatë vitit 2017, duke marrë për bazë të dhënat e fundit që i kemi në dispozicion.

Gjatë këtij viti, sektori bankar fuqizoi edhe më tutje rolin e tij në mbështetje të zhvillimit dhe të stabilitetit të ekonomisë së vendit, duke rritur kreditimin dhe duke përmirësuar kushtet e financimit përmes zvogëlimit të normave të interesit.

Gjithsej vlera e kredive aktive në sektorin bankar të Kosovës në nëntor 2017 (të dhëna preliminare) arriti në 2.4 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.0 përqind. Rritja e kredive rezultoi nga lehtësimi i standardeve dhe kushteve të kreditimit nga ana e bankave dhe po ashtu nga rritja e kërkesës për kredi. Vlen të theksohet se njëri ndër sektorët me rritjen më të lartë të kreditimit gjatë kësaj periudhe ka qenë sektori i ndërtimtarisë, kreditë për të cilin shënuan rritje vjetore prej 23.6 përqind, pasuar nga rritja e kredive për sektorin e minierave (15.3 përqind) dhe për atë të prodhimtarisë (11.5 përqind). Kjo tregon për rritje të përkrahjes së sektorit bankar ndaj sektorëve me potencial më të lartë për gjenerim të një zhvillimi më të madh ekonomik të vendit.

Aktiviteti kredidhënës i sektorit bankar të Kosovës vazhdon të financohet nga rritja e qëndrueshme e depozitave, kryesisht të mbledhura mbrenda vendit, të cilat po vazhdojnë të rriten me ritëm të qëndrueshëm. Vlera e përgjithshme e depozitave në sektorin bankar arriti në 3.05 miliard euro në nëntor 2017, duke shënuar kështu një rritje vjetore prej 8.2 përqind.

Gjatë vitit 2017, sektori bankar ka vazhduar të përmirësojë kushtet e financimit kreditor, duke zbritur edhe më tutje normat e interesit në kredi. Norma mesatare e interesit në kredi në tetor 2017 ishte 6.8 përqind, krahasuar me normën prej 7.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ky zvogëlim i normës së interesit reflekton zhvillimin e qëndrueshëm dhe efikas të sistemit bankar, rritjen e vazhdueshme të konkurrencës, si dhe masat e ndërmarra për përmirësimin e ambientit të përgjithshëm afarist në vend, përfshirë rritjen e efikasitetit në zbatimin e kontratave.

Gjatë vitit 2017, sektori bankar përforcoi edhe më tutje treguesit e qëndrueshmërisë. Norma e kredive joperformuese e cila edhe ashtu ishte në nivel

mjaft të ulët, gjatë vitit 2017 vazhdoi të shënojë rënie të mëtutjeshme. Norma e kredive joperformuese në nëntor 2017 u zvogëlua në 3.5 përqind krahasuar me 4.8 përqind sa ishte nëntor 2016. Kjo normë e kredive joperformuese paraqet nivelin më të ulët të regjistruar që nga viti 2008 dhe vazhdon ta mbajë Kosovën si vendin me normën më të ulët të kredive joperformuese në rajon dhe në nivel të ngjashëm me shumë vende të zhvilluara.

Sektori bankar po ashtu vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit, me tregues të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 18.7 përqind, që është dukshëm më i lartë se sa minimumi i kërkuar rregullativ. Gjendja e likuiditetit vazhdon të jetë po ashtu e kënaqshme. Treguesi i likuiditetit në nëntor 2017 ishte 37.2 përqind, që është dukshëm më i lartë se sa minimumi i kërkuar rregullativ prej 25 përqind.

Performanca financiare e sektorit bankar vazhdoi të jetë e kënaqëshme edhe gjatë vitit 2017. Profiti i sektorit gjatë periudhës janar – nëntor 2017 arriti vlerën prej 85.4 milionë euro. Profiti i qëndrueshëm paraqet një shtyllë shumë të rëndësishme të shkallës së përgjithshme të qëndrueshmërisë së këtij sektori.

Me rritje të aktivitetit u karakterizuan edhe sektorët tjerë përbërës të sistemit financiar. Asetet e sektorit pensional në shtator 2017 arritën vlerën 1.58 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.2 përqind, si dhe shënuan normë pozitive të kthimit nga investimet.

Asetet e sektorit të sigurimeve kanë shënuar rritje prej 4.3 përqind, duke arritur vlerën 173.1 milionë euro në shtator 2017. Vlen të theksohet se sektori i sigurimeve gjatë vitit 2017 shënoi performancë pozitive, duke regjistruar një profit neto prej 3.2 milionë euro deri në shtator 2017. Performanca pozitive e sektorit të

sigurimeve në masë të konsiderueshme reflekton masat e ndërmarra nga BQK-ja për përmirësimin e gjendjes së këtij sektori.

Sektori mikrofinanciar gjatë vitit 2017 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit, me ç'rast vlera e përgjithshme e aseteve të këtij sektori arriti në 188.1 milionë euro në tetor 2017. Gjithsej kreditë e sektorit financiar në tetor 2017 arritën vlerën prej 137.7 milionë, duke shënuar një rritje vjetore prej 31.3 përqind, e cila flet për intensitet mjaft të lartë të aktivitetit kredidhënës të këtij sektori. Portofoli kreditor i këtij sektori vazhdon të karakterizohet me cilësi mjaft të mirë, ku kreditë joperformuese përfaqësonë vetëm 2.5 përqind të gjithsej kredive.

Për sa i përket performancës makroekonomike të ekonomisë së vendit, viti 2017 vlerësohet të jetë karakterizuar me një ritëm të përshpejtuar të rritjes ekonomike. BQK vlerëson se norma reale e rritjes ekonomike në vitin 2017 është rreth 4.4 përqind, që paraqet normë më të lartë krahasuar me rritjen prej 4.1 përqind në vitin 2016.

Rritja e kreditimit bankar ka vazhduar të jetë njëri ndër burimet kryesore të financimit të rritjes ekonomike në vend. Kontribut të rëndësishëm në rritjen ekonomike gjatë këtij viti kanë dhënë edhe zhvillimet pozitive që e kanë karakterizuar sektorin e jashtëm të ekonomisë. Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave është përmirësuar, kryesisht si rezultat i rritjes më të theksuar të eksportit të mallrave dhe shërbimeve si dhe rritjes së remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë deri në shtator 2017 kanë arritur vlerën prej 560.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.1 përqind. Eksporti i mallrave gjatë kësaj periudhe ka shënuar rritje vjetore prej 25.8 përqind dhe ka arritur vlerën prej 318.4 milionë euro, përderisa importi i mallrave është rritur për 9.0 përqind dhe ka arritur vlerën

prej rreth 2.5 miliardë euro. Norma më e lartë e rritjes së eksportit të mallrave krahasuar me importin ka ndikuar që shkalla e mbulueshmërisë së importit me eksport në tetor 2017 të arrijë në 12.8 përqind nga 11.1 përqind sa ishte në tetor të vitit 2016. Sidoqoftë, deficitit tregtar vazhdon të përbëjë një sfidë të rëndësishme për ekonominë e vendit. Deri në tetor 2017, deficitit tregtar i mallrave është rritur për 6.9 përqind duke arritur nivelin prej 2.17 miliardë euro.

Kontributi më i rëndësishëm në rritjen ekonomike gjatë vitit 2017 i përket rritjes së investimeve. Investimet publike deri në tetor 2017 kanë arritur vlerën prej 319.3 milionë euro e cila është për 9.4 përqind më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Nivel i ngjashëm i rritjes është vlerësuar edhe tek investimet private, ku vlen të theksohen investimet e huaja direkte të cilat arritën vlerën prej 201.5 milionë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 10.5 përqind deri në shtator 2017.

Për sa i përket zhvillimeve në nivelin e përgjithshëm të çmimeve, norma mesatare e inflacionit gjatë periudhës janar-nëntor 2017 ishte 1.6 përqind e cila rezulton të jetë më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur norma e inflacionit ishte 0.2 përqind. Niveli më i lartë i inflacionit gjatë këtij vit kryesisht pasqyron zhvillimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, të cilat në Kosovë u reflektuan përmes rritjes së çmimeve të mallrave të importuara.

Viti 2017 ishte një vit i suksesshëm edhe për vetë zhvillimin e BQK-së. Gjatë këtij viti, në saje të angazhimit dhe përkushtimit të lartë të të gjithë punonjësve dhe drejtuesve të BQK-së si dhe partnerëve tanë vendorë e ndërkombëtarë, ne kemi arritur të vazhdojmë avancimin e të gjitha funksioneve të BQK-së.

Një shpalosje më të detajuar të zhvillimeve ekonomike e financiare, si dhe mbi aktivitetet e BQK-së gjatë vitit 2017 do të mund ta gjeni në Raportin Vjetor të BQK-së i cili do të publikohet në pjesën e parë të vitit të ardhshëm.

Pa dashur të zgjas këtë diskutim më tepër, më lejoni të ju falënderoj përzemërsisht për bashkëpunimin dhe korrektësinë që keni vazhduar ta shfaqni ndaj BQK-së edhe në vitin që po e lëmë pas dhe t'ju uroj një vit të ri me shumë shëndet, lumturi dhe të arritura të mëtutjeshme juve dhe familjeve tuaja. Le të jetë një vit ku do të mbizotërojnë zhvillimet pozitive dhe fryma e bashkëpunimit në mes të gjithë neve.